



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.156/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Afijete Sada-Gllogjani dhe Ymer Hoxha anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së posterit në shtyll elektrike të kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Ferizaj, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 12.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dhe subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 250.00 (dyqind e pesëdhjet) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Me datën 10.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me të cilën pretendon se me datën 09.10.2017 në rrugën Kadri Zeka në Ferizaj kanë hasur posterin e kandidates për anëtare të kuvendit komunal në Ferizaj Saranda Musliut nga subjekti politik LDK të vendosur në shtyll elektrike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës 13/2014, si dhe nenit 33 pika b) të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 11.10.2017, subjekti politik LDK, konsideron si të pabazuar ankesën për faktin se shkelja e pretenduar nuk paraqet shkelje, dhe se posterit i bashkangjitur ankesës duhet të ketë mbetur i harruar pa u larguar më parë pasi që rreth të njëjtës kandidate jemi gjobitur edhe më parë. Përkundër kësaj subjekti politik LDK ka kërkuar nga dega e saj në Ferizaj që të ndërmar të gjitha masat dhe ta evitoj shkeljen e supozuar me ankesë.

Si dëshmi ka bashkangjitur fotografit me të cilat shihet se është larguar posterit nga vendi ku ka qenë i vendosur.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterit i kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal Ferizaj nga LDK-ja Saranda Musliu është

vendosur në shtyll elektrike gjegjësisht në objekt publik, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton: “Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave, njoftimeve dhe slloganeve, në objekte publike.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik LDK, është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posteri reklamues i kandidatës për anëtare të Kuvendit Komunal në Ferizaj nga ky subjekt politik, është vendosur në objekt publik,

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik LDK, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thot se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se përkundër këtij fakti posteri reklamues i kandidatës nga subjekti politik LDK është vendosur në shtyll elektrike. Poashtu si rrethanë Paneli mori edhe faktin se subjektit politik në fjalë ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarr veprime për të bërë përmisimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterin nga vendi i palejuar ku ka qenë i vendosur ai.

Paneli gjat vendosjes mori parasysh edhe faktin se subjekti politik LDK ka bërë përpjekje serioze të përcaktuar me nenin 32 par.6 pikat a), b), c), d),e) të LZP-së, për ti parandaluar parregullësit që po shkaktohen nga simpatizantët apo mbështetësit e subjektit në fjalë, dhe ky veprim i subjekti në fjal nga paneli është vlerësuar pozitivisht dhe ka ndikuar në lartësin e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

ZL. Anr.156/2017 më datën 12.10.2017.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.